

COBISS.AL në rrjetin COBISS.Net

1. Çfarë është COBISS.AL?

COBISS.AL është sistem i përbashkët bibliografik për vlerësimin e rezultateve të kërkimit në Shqipëri, i ndërtuar në vitin 2012. Ky sistem mund të shërbejë edhe si bazë për sistemin e ardhshëm të informacionit të bibliotekave në Shqipëri brenda rrjetit COBISS.Net, me kusht që të gjitha bibliotekat e rëndësishme shqiptare të zgjedhin dhe të miratojnë atë si sistemin e tyre të informacionit bibliotekar.

Deri në formimin e Qendrës Kombëtare COBISS (QKC) në Tiranë, të gjitha aktivitetet që lidhen me zhvillimin dhe funksionimin e shërbimit COBIB.AL i koordinon Shërbimi COBISS Shqiptar, i cili u organizua nga IZUM - UNESCO Qendra Rajonale për sistemet e informacionit bibliotekar dhe sistemet e informacionit kërkimor (Slloveni) në bashkëpunim me Akademinë Shqiptare të Shkencave.

2. Çfarë është katalogimi i përbashkët?

Katalogimi i përbashkët në rrjetin COBISS.Net është procesi i përpunimit të përbashkët të materialeve bibliotekare (libra, seriale, artikuj, materiale jolibër...) në të cilin marrin pjesë katalogues nga biblioteka të ndryshme, të cilët shkëmbejnë midis tyre regjistrimet bibliografike. Çdo njësi bibliografike katalogohet fillimisht vetëm një herë në një nga vendet pjesëmarrëse, më pas kataloguesit e bibliotekave të tjera mund ta kopjojnë regjistrimin bibliografik pa pagesë në bazën e tyre lokale dhe sistemet kombëtare bibliografike. Kjo çon në kursime të konsiderueshme në burimet njerëzore dhe ndihmon racionalizimin e shpenzimeve jo vetëm në nivelin e bibliotekave të veçanta, por edhe në nivelin e çdo biblioteke brenda sistemit COBISS.Net.

3. Çfarë është baza e të dhënave COBIB dhe cili është qëllimi i bazës lokale të të dhënave?

Në procesin e katalogimit të përbashkët në sistemin bibliografik secila nga vendet pjesëmarrëse apo pjesët e tyre përbërëse, ndërtojnë bazën e përbashkët bibliografike COBIB, që përfaqëson katalogun unik, i cili tregon se cilat biblioteka pjesëmarrëse zotërojnë materialet e caktuara. Lidhur me sistemin e informacionit kërkimor E-CRIS, baza e përbashkët e të dhënave COBIB përdoret edhe për monitorimin e rezultateve kërkimore në formën e bibliografive personale të kërkuesve shkencorë.

Baza e përbashkët bibliografike e të dhënave-katalogu COBIB.AL, u krijua në dhjetor të vitit 2012, fillimisht nga shkarkimi dhe mbledhja e regjistrimeve bibliografike nga katalogu lokal i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, nga baza të tjera të përbashkëta të të dhënave në rrjetin COBISS.Net (COBIB.MK, COBIB.SR, COBIB.SI, COBIB.CG, COBIB.BH dhe COBIB.BG), nga katalogu ndërkombëtar WorldCat – OCLC, nga regjistri i ISSN-së dhe nga Web of Science (gjithsej 68.743 regjistrime bibliografike – kryesisht për vepra në gjuhën shqipe dhe vepra të

kërkuesve shkencorë shqiptarë në gjuhë të huaja). Baza e të dhënave po ndërtohet nga bibliotekat shqiptare, të cilat janë të përfshira në sistemin COBISS.AL dhe deri më dt. 31.12. 2015 kanë kontribuar me 20.780 regjistrime bibliografike (të krijuara ose të shkarkuara nga sistemet e vendeve të tjera).

Nëpërmjet procesit të katalogimit të përbashkët, përveç bazës së përbashkët të të dhënave bibliografike, çdo bibliotekë ndërton bazën e saj lokale bibliografike, që është katalogu lokal, në të cilin është bazuar automatizimi i proceseve të punës në bibliotekë (p.sh pasurimi dhe inventarizimi i materialit bibliotekar, huazimi etj.)

4. Çfarë pritet nga një bibliotekë që merr pjesë në sistemin e përbashkët të katalogimit?

Regjistrimet bibliografike të krijuara në sistemin e përbashkët të katalogimit janë dizenuar (përcaktuar) për përdorime të ndryshme. Çdo gabim i mundshëm në regjistrimet bibliografike mund të krijojë efekt kritik në përdorimin e regjistrimeve të tilla si edhe në funksionin e një sërë aplikimeve; me kopjimin e regjistrimeve, që kanë cilësi të ulët, në bazën lokale të të dhënave dhe në sisteme të tjera bibliografike shumëfishohen problemet.

Bibliotekat dhe kataloguesit e përfshirë në katalogimin e përbashkët duhet të jenë vetëdijshëm për efektet që ka puna e tyre te bibliotekat dhe kataloguesit e tjerë. Kur krijohen regjistrimet, duhet në mënyrë rigorozë të ndiqen rregullat e katalogimit dhe rregullat e formatit COMARC për të arritur kriterin e cilësisë së regjistrimeve individuale bibliografike dhe me to edhe cilësinë e bazës lokale të të dhënave të bibliotekave dhe bazës së përbashkët COBIB. Kjo bëhet e mundur vetëm me trajnimet e duhura të stafit bibliotekar për procesin e katalogimit. Cilësia e regjistrimeve bibliografike është fillimisht përgjegjësi e bibliotekave që monitorojnë punën e kataloguesve të tyre.

5. Çfarë kualifikimi është i nevojshëm për t'u bërë katalogues?

Kataloguesit të cilët përmes krijimit të regjistrimeve origjinale (nga e para) marrin pjesë aktive në katalogimin e përbashkët, duhet të kenë diplomë universitare në fushën e bibliotekave, ose të kenë diplomë universitare në disiplina të tjera, por duhet të jenë të pajisur me çertifikatën e kursit të bibliotekonomisë.

Nga ana tjetër, për kataloguesit të cilët vetëm do të kopjojnë regjistrimet bibliografike nga baza e përbashkët e të dhënave në bazën e tyre lokale, diploma universitare nuk është e domosdoshme, nuk është kusht.

6. Çfarë kualifikimi kërkohet për katalogimin e përbashkët në COBISS.AL?

Gjatë trajnimit për katalogimin e përbashkët, një bibliotekar duhet të njihet me rregullat e katalogimit dhe të formatit COMARC për shkëmbimin e të dhënave të cilat bazohen në standardet ndërkombëtare; bibliotekari duhet të njihet edhe me funksionet e programit COBISS3/Katalogimi. Kjo përcillet me trajnime në mjedisin testues për katalogimin e

përbashkët, krijimin dhe verifikimin e regjistrimeve testuese, dhe së fundmi por jo e parëndësishme me testimin e njohurive për katalogimin e llojeve të ndryshme të materialit bibliotekar. Trajnimi ofrohet në dy pjesë: katalogimi i monografive-librave (gjithësej 16 ditë) dhe më pas kontrolli i termave të njësuar si dhe katalogimi i burimeve në vazhdim, pjesëve përbërëse dhe materialeve jolibra (në numër të ndryshëm ditësh).

Kualifikimi për katalogimin e përbashkët nuk është i përhershëm dhe duhet të mbahet nga një katalogues me punë praktike, në të kundërtën lejet dhe privilegjet që ai zotëron nga licensat e marra nga trajnimet do të skadojnë/përfundojnë.

Për bibliotekarët të cilët vetëm do të shkarkojnë regjistrime në bazën lokale nga baza e përbashkët e të dhënave, trajnimi i lartpërmendur nuk është i nevojshëm. Megjithatë bibliotekarët e tillë, duhet të ndjekin kursin *Përdorimi i programit COBISS3/Koleksionet e bibliotekës – monografitë dhe serialet* (3 ditë).

7. Sa katalogues duhet të trajnohen në një bibliotekë për katalogimin origjinal (regjistrime të reja)?

Nëse për krijimin e një regjistrimi bibliografik origjinal, konsiderohet që nevojiten 20 deri në 60 minuta (varësisht nga lloji i materialit, për materialet arkivë edhe më shumë), mesatarja vjetore e kapacitetit të një kataloguesi të tillë është 2,500 regjistrime bibliografike.

Bibliotekave me shumë bibliotekarë u rekomandohet, që për katalogim origjinal të trajnojnë numër të arsyeshëm të bibliotekarëve. Katalogimi është punë profesionale mjaft e ndërlikuar, për të cilën është i nevojshëm specializimi përkatës dhe përmirësimi i vazhdueshëm i dijes me punë praktike. Kataloguesi, brenda tre viteve duhet të krijojë të paktën 100 regjistrime të reja bibliografike në bazën e përbashkët të të dhënave COBIB.AL (përfshirë regjistrimet e shkarkuara dhe të redaktuara nga rrjeti COBISS.Net dhe nga bazat e tjera të huaja të të dhënave), përndryshe i merret leja për katalogimin e përbashkët.

8. Çfarë kushte duhet të plotësojnë bibliotekat për t'u përfshirë në sistemin COBISS.AL?

Sistemit mund t'i bashkohet çdo bibliotekë, e cila është e interesuar dhe ka bibliotekarë me kualifikimin dhe njohuritë e duhura në fushën e bibliotekonomisë.

Deri më tani çdo bibliotekë është dashur të firmosë vetëm një deklaratë, që pranon kushtet e përgjithshme të bashkëpunimit dhe shkëmbimin e lirë të regjistrimeve bibliografike brenda rrjetit COBISS.Net, siç është e specifikuar në Platformën COBISS, dhe kataloguesve të vet t'u mundësojë ndjekjen e plotë të trajnimeve të përshkruara. Pas formimit të Qendrës Kombëtare COBISS në Tiranë, të gjitha bibliotekat duhet të nënshkruajnë me këtë qendër kontratën për anëtarësim me të drejta të plota në sistemin COBISS.AL.

Bibliotekarët (pjesëmarrësit e trajnimit) paraprakisht duhet të pranojnë, që pas përfundimit të trajnimit do të katalogojnë në bazën e përbashkët të të dhënave COBIB.AL dhe të krijojnë të

paktën 1.250 regjistrime të reja bibliografike (normë gjashtëmujore). Përfshirë nga ky numër i regjistrimeve mund të jenë vetëm bibliotekat me një të punësuar.

9. Çfarë angazhime financiare mund të presin bibliotekat pas formimit të QKC-së?

Si rregull IZUM bashkëvepron me bibliotekat jashtë Sllovenisë nëpërmjet Qendrave Kombëtare COBISS (QKC) në bibliotekat kombëtare të vendeve pjesëmarrëse.

Qendra Kombëtare COBISS është e detyruar t'i paguaj IZUM-it:

- 1,000.00 euro sa herë që programi do të instalohet dhe implementohet në një bibliotekë të re që përfshihet në sistemin kombëtar;
- 25.00 euro një licencë mujore për përdoruesit korrentë (e drejta për të përdorur dhe mirëmbajtur programin COBISS dhe manualët e përdoruesit).

Përdormi i COBISS/OPAC dhe aplikacionet e bibliografive janë pa pagesë.

Biblioteka individuale është e detyruar t'i paguaj Qendrës Kombëtare të COBISS-it:

- Kuotën vjetore të anëtarësisë, përfshirë kuotat e licencës për programin dhe kostot e operacioneve të QKC-së, nëse QKC dështon të siguroj fonde për këtë qëllim nga burime të tjera (ministritë);
- Kuotat e shërbimeve trajnuese, nëse QKC dështon në sigurimin e fondeve për këtë qëllim nga burime të tjera.

10. Çfarë lloj ndihme për zhvillim kanë marrë deri tani bibliotekat në kuadër të projektit COBISS.Net?

- Bibliotekat, të cilat deri tani janë përfshirë me sistemin COBISS.AL janë përjashtuar nga pagesa 1,000.00 euro për instalimin dhe implementimin e programit COBISS, ndërsa të gjitha bibliotekat (përfshirë edhe ato që janë lidhur me sistemin në vitin 2013) do të përjashtohen nga pagesa 25.00 euro për kuotat e licensës mujore për përdoruesit korrentë (e drejta për përdorimin dhe mirëmbajtjen e programit COBISS dhe manualët e përdoruesit). Bibliotekat janë financuar gjithashtu edhe për blerjen e kompjuterave personal (PC) dhe printerave për etiketat me barkode.
- Trajnimi i kataloguesve deri tani ka qenë pa pagesë (financimi është bërë nga Qeveria e Republikës së Sllovenisë).
- Bibliotekat, të cilat në vitin 2013 kanë krijuar mbi 100 regjistrime të reja bibliografike, janë subvencionuar duke marrë 3,00 euro për çdo regjistrim të ri në COBISS.AL. Bibliotekat, kataloguesit e të cilave në vitin 2014 dhe/ose 2015 kanë krijuar në mënyrë individuale më shumë se 250 regjistrime të reja bibliografike, IZUMI-i do t'i shpërblejë duke bashkëfinancuar 50 % të regjistrimeve të kataloguesve të sipërpërmendur..

IZUM është duke bërë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar fonde nga burime të ndryshme për ndihmë në zhvillimin e bibliotekave brenda rrjetit COBISS.Net (Qeveria e Republikës së Sllovenisë, Komisioni European etj.). Suksesi i përpjekjeve të tij, varet edhe nga bashkëpunimi i ministrive dhe agjensive përkatëse të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në koordinimin e aktiviteteve të projektit.